



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 116, datë 15.12.2017

PËR
AKREDITIMIN PERIODIK TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË
KOLEGJI UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, "Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë" dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, "Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit",

si dhe

në zbatim të Kontratës së Përgjithshme të Projektit "Për ofrimin e ekspertizës për Sigurimin e Cilësisë në mbështetje të krijimit të materialeve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, trajnimit të ekspertëve vlerësues të jashtëm dhe ekspertizës në mbështetje të vlerësimit të jashtëm të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri", Nr. 2064 Prot., datë 29.02.2016, lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Garantimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në Mbretërinë e Bashkuar,

në mbledhjen e tij të datës 15.12.2017, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin institucional të **Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"**, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i Institucionit të Arsimit të Lartë: **Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"**
- b) Organizimi i Institucionit: **Jopublik**

- c) Lloji i Institucionit: **Kolegj Universitar**
- d) Njësitë kryesore të Institucionit:
 - a. Fakulteti i Inxhinierisë
 - b. Fakulteti Ekonomisë
- e) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 781, datë 10.11.2011
- f) Akreditimi i parë: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 139, datë 25.03.2016
- g) Akti i riorganizimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 556, datë 24.11.2016

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e përgjithshme institucionale, Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- b. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- c. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e Agjencisë Britanike dhe atyre vendas në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- d. Rezultatet e Vlerësimit të Jashtëm të Institucionit;
- e. Mangësitë e evidentuara dhe rekomandimet e lëna nga vlerësimi i jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e Institucionit në kuadër të këtij procesi;
- h. Rezultatet e vlerësimit dhe akreditimit të parë për këtë Institucion si dhe plotësimin e rekomandimeve të lëna në kuadër të tij;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në Kontratën MAS-QAA për këtë proces;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimin e Jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në Institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet: pikat e forta, pikat e dobëta dhe afirmimet e identifikuara e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në Institucion;
- e. Rekomandimet e lëna janë në koherencë me gjetjet si dhe shkallën e përmbushjes së standardeve të cilësisë për Institucionin në fjalë;
- f. Rezultatet e vlerësimit të Jashtëm në lidhje me shkallën e plotësimit të Standardeve Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë sipas fushave janë: Fusha 1 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 2 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 3 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 4 “**përmbushen kryesisht**”, Fusha 5 “**përmbushen plotësisht**”, ndërsa vlerësimi i përgjithshëm “**përmbushen plotësisht**”;
- g. Vlerësimi përfundimtar i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për cilësinë akademike për këtë Institucion është Pozitiv;

h. Rezultati i akreditimit të mëparshëm të këtij Institucioni është Pozitiv.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

- 1. Vlerësimin Përfundimtar POZITIV** për Institucionin e Arsimit të Lartë, **Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"**, me rekomandimet sipas Shtojcës së këtij Vendimi.
- 2. Akreditimin Institucional** të Institucionit të Arsimit të Lartë, **Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"**, me kohëzgjatjen prej **5 (pesë)** vite akademike. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të Institucionit është **14/12/2022**.
- 3.** Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij Vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda 14 ditëve nga zbardhja e këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas Shtojcës bashkëlidhur.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

ARJAN GJONÇA



Kryetar

ALEXANDER KOHLER



Anëtar

FABRICE HENARD




Anëtar

ARBEN MERKOCI



Anëtar

ALEKSANDËR XHUVANI



Anëtar

ANILA PAPARISTO



Anëtar

SULO HADËRI



Anëtar

LULJETA MINXHOZI *Luljeta Minxhozi* Anëtar

MYFTAR BARBULLUSHI Anëtar

ILIR PANDA Anëtar

FATMIR GURI Anëtar

